Mal Berisha



"NOTES ON ALBANIA", EDICIONI I PARË

NOTES ON ALBANIA
Royal Collage of Music London
Londër, 16 Dhjetor 2012
Organizuar nën patronazhin e Ambasadorit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar,
Mal Berisha,
me pjesëmarrjen e sopranos me famë botërore
Ermonela Jaho,
Arlinda Morava dhe Orkestrës London–Albanian,
nën drejtimin e Mariela Cingo.

BY MAL BERISHA



“NOTES ON ALBANIA”, EDICIONI I PARË, 16 DHJETOR 2013

Në kërkim të një metode sa më efikase për promovimin e Shqipërisë në Britaninë e Madhe, dhe në zbatim të teorisë së “Forcës së Pushteti të Butë”,të cilin po e zbatoja në atë kohë në praktikën e punës time, bashkë me anëtarët e stafit tim u munduam të gjenim forma, të cilat do të tërhiqnin një masë sa më të madhe anglezësh në audiencat tona, shqiptare. Gjatë një bisede me diplomatet e ambasadës, Dr. Teuta Starova dhe Dr Xhoana Papakostandini, hartuam një platformë për organizimin e një veprimtarie të ndërthurur artistike me artistët shqiptarë, që performonin në Brianinë e Madhe. Ishin disa, por në atë kohë ata nuk kishin arritur të kapnin skenat e mëdha të Londrës, me përjashtime të vogla. Kështu bënim një rrugë e dy punë: Edhe promovimin e tyre edhe rrisnim emrin e shqiptarëve në Britani.

Emërtimi “Notes on Albania” i përdorur dikur nga Rose Wilder Lane,

Kështu më së pari na u desh të emërtonim atë veprimtari me një emër, i cili të bënte përshtypje. Në atë kohë po lexoja shumë materiale nga gazetarja e famshme amerikane, Rose Wilder Lane, e cila ka lënë një mori veprash të shkruara për Shqipërinë, të cilat ruhen në Koleksionin e Presidentit Herbert Hoover në

Standford të Kalifornisë. Ndër to spikaste libri “Majat e Shalës”. E veç atij libri të saj, ishte edhe një bllok shënimesh të marra në Shqipëri me një titull mbresëlënës: “*Notes On Albania*”. Ky titull u përdor prej asaj zonje qysh në vitin 1925 në udhëtimet e saj dhe madje qëndrimin në kryeqytetin tonë, Tiranë. Atëherë ne vendosëm që atë aktivitet ta quanim pikërisht me këtë emër.

Reputacioni lëndues i disa shqipatërve në Londër

Nga shtëpia ime në Vaxhual Bridge Road, pranë stacionit të metrosë, Pimlico, çdo ditë një njeri më zgjaste një gazetë pa para, të quajtur “Evening Post”. Ajo ishte e mbushur me lajme sensacionale, kronikë të zezë dhe… më e keqja, shumë herë në faqet e saj përmendeshin edhe shqiptarë. Nuk ka ndjenjë më të keqe sesa kur je në atë detyrë, dhe sheh në shtyp ose televizion lajme të tilla për bashkatdhetarët tanë. Një mijë arsye më shtynin për të organizuar diçka, që deri në atë kohë nuk ishte organizuar në Londër, për të sfiduar atë përshtypje që krijonin gazetat sensacionale…

Platforma dhe pjesmarrësit

Pasi e ndërtuam platformën, duhej bërë lista e pjesëmarrësve. Artistja e parë që na vajti në mendje ishte sopranoja e njohur dhe një vizitore e shpeshtë e

Operas Mbretërore në Londër, ROH, Ermonela Jaho. Njohja që kisha me të nëpërmjet të fotografit të mirënjohur në New York, Fadil Berisha, më dha mundësinë të komunikoja dhe t'i paraqitja idenë, që kishim. Ajo e priti me shumë gëzim dhe premtoi se do të vinte në shfaqjen e Ambasadës dhe nuk kërkonte asnjë lloj shpërblimi, duke e konsideruar një nder që i bënte vendi i saj dhe nderi, që ajo do t'i bënte vendit të vet.

U vendos që edicioni i parë i "Notes on Albania" të bëhej më 16 dhjetor 2013, njëra nga ditët kur Ermonela kishte pushimin e saj nga Opera Mbretërore e Londrës. Me atë rast do të festonim edhe Ditën e Shpalljes së Pavarësisë, kuptohet me më shumë se dy javë vonesë, por në Londër kjo ndodhte shpesh me ambasadat, të cilat i shënonin datat e tyre kombëtare në një ndër datat, që atyre iu përshtatej, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë, si për shembull, mospërplasja me veprimtari të tjera, të cilat e mbivendoseshin. Kishim vënë gurin e parë të kësaj gjëje, që rezultoi të ishte shumë i bukur. Pas kësaj bisedova me artistët, që vepronin në Londër, duke iu adresuar më së pari violinistes së njohur shqiptare, Alda Dizdari. Ajo e pranoi me gëzim dhe respekt ftesën dhe premtoi se nuk do të kishte asnjë pretendim financiar. Më tej rashë në kontakt me mezo - sopranon shqiptare, që performonte në Operan Rumune, Arlinda Morava, e cila u tregua e gatshme të vinte dhe t'u bashkoihej artistëve të tjerë shqiptarë.

Koncerti u zhvillua në sallën “Amaryllis Fleming Concert Hall” të Kolegjit Mbretëror të Muzikës në Londër. Ai u ndoq nga një audiencë e gjerë prej mëse 400 spektatorësh, ku kishte ambasadorë, diplomatë, lordë, parlamentarë, profesorë universitetesh, muzikologë, anëtarë të Shoqatës Anglo - Shqiptare, biznesmenë, dashamirës anglezë të muzikës, bashkatdhetarë me banim në Britaninë e Madhe etj.

Historia e këtij kolegji shkon shumë larg dhe është themeluar në vitin 1882. Ai është i vendosur në South Kensington. Aty organizohen trajnimet e nivelit më të lartë në të gjitha aspektet e muzikës përendimore. Ai është njëri nga pjesëtarët e Bordit të Asociuar të Shkollave Mbretërore të Muzkës dhe pjesë e Konservatorit të Britanisë së Madhe. Ky kolegj është i vendosur pranë Pallatit Mbretëror të Artit, që mban emrin e Albertit, bashkëshorti i Mbretëreshës Victoria.

Salla e Koncerteve të këtij Kolegji mban emrin “Amaryllis Fleming”, e cila është një hapësirë performuese e standardit më të lartë ndërkombëtar, që mund të strehojë koncerte të mëdha orkestrale dhe korale. Salla ka marrë emrin e Amaryllis Fleming për nder të muzikantes dhe edukatores së muzikës me të njëjtin emër.

Në qendër të koncertit ishte emri dhe frymëzimi i artistes tashmë me famë botërore, Ermonela Jaho, ndërsa programi i saj u plotësua me zërin e sopranos

tjetër shqiptare e ardhur enkas në Londër nga Bukureshti, Arlinda Morava, shoqëruar në piano nga Maestro Petrescu dhe viloniçelistja Klara Bregu, me tingujt e violinës së Alda Dizdarit dhe melioditë e mrekullueshme të luajtura nga Alb - Trio e Londrës, e drejtuar nga pianistja Mariela Cingo.

Hapjen e koncertit e bëri prezantuesja Kristale Rama, një vajzë amerikane me prindër shqiptarë nga Tuzi, dhe më pas ua urova mirëseardhjen artistëve dhe spektatorëve.

Shfaqja u përshkrua nga një ritëm i lartë, plot emocione dhe u ndoq me interes të jashtëzakonshëm. Në mënyrë të veçantë u mirëpritën ariet e operave, si ajo e Puçinit "O mio babbino caro" nga Opera "Gianni Schicchi", "Manon" nga Opera me të njëjtin titull e Jules Massenet, interpretuar nga Ermonela Jaho, pastaj këngët shqiptare, "Moj e bukura More", "Perëndeshë e bukurisë" kënduar nga Arlinda Morava. Alb - Trioja London, luajti Mendelson, ndërsa muzika e bukur e Limos Dizdarit u interpretua nga e bija e tij, violinistja e njohur, Alda Dizdari. Koncerti arriti kulmin me "Sempre Libera" nga "Traviata" e Verdit interpretuar nga Diva shqiptare dhe u mbyll në mënyrë madhështore me këngën "Të duam më shumë Shqipërinë" ekzekutuar nga të gjithë artistët.

Ky aktivitet kaq madhështor na mësoi shumë gjëra:

E para, kur ka dëshirë dhe vullnet, çdo gjë arrihet. Nga buxheti i Ambasadës nuk u shpenzua asnjë cent (le që ku kishte buxhet për atë punë!). Marrëveshja me sallën u bë me një paradhënie (jo nga ambasada), që iu siguronte teatrin se ata nuk do të humbsinin asgjë në rast, mos e thashtë Zoti, të dështimit të veprimtarisë; Biletat e shitura online e përballuan më së miri shpenzimin e bërë për sallën, teknikën dhe shërbimet e tjera;

Së dyti, u provua se artistët shqiptarë janë aq patriotë sa janë të gatshëm të performojnë pa asnjë kusht, për të ndritur emrin e vendit të tyre, mjafton që dikush t'i mobilozojë.

Mbas kësaj veprimtarie, njëri nga atdhetarët tanë nga Kosova, inxhinieri Përparim Rama shtroi një darkë për trupën interpretuese dhe personelin e ambasadës. Përpara se të organziohej veprimtaria, kishim porositur tek Argjendaria Pirro 13 pllaketa të bukur në bakër të personalizuara me emrat e të gjithë pjesmarrësve, të cilat çertifikonin pjesëmarrjen e tyre në atë veprimtari. Kështu filloi një rrugëtim, i cili do të ishte bërë një traditë e mrekullueshme, nëse nuk do të ndërpritej nga vet shteti shqiptar.

Pas këtij aktiviteti vërshuan kërkesat e artistëve shqiptarë, që performonin nëpër skena të ndryshme të Europës dhe Botës, dhe ishin gati që të jepnin kontributin e tyre në Londër në nderim të atdheut të

tyre. Kjo do të pasqyrohet në artikullin, që pason mbi veprimtaritë "Notes on Albania" 2, dhe 3.

Në referencë të këtij edicioni të parë të "Notes on Albania" dëshiroj të sjell një mesazh të sopranos sonë shumë të njohur e të suksesshme që e nderon Shqipërinë në sallat më të mëdha të botës, zonjën Ermonela Jaho.

Ajo më shkruan:

Ta ndjesh veten shqipëtare dhe ta nderosh emrin e Shqipërisë

Të jesh një artiste e ardhur nga një vend kaq i vogël por me një histori shekullore si kjo e Shqipërise tonë të dashur është një privilegj i madh. Për më tepër, të performosh në teatrot më të mëdha të botës, ku konkurenca me artistët e tjerë është kaq e madhe dhe të arrish të dalësh në maje, kjo është një arritje e jashtëzakonëshme. E të demonstrosh shpirtin e madh të kombit tonë, artin dhe kulturën, në formën e vet më sublime është një detyrim e nder.

Shqipëria ka nxjerrë aq shumë artistë sa në përpjestim me popullsinë e saj mund të përbëjë një fenomen që nuk mund dhe nuk duhet të kalojë pa u vënë re. Ne çdo cep të botës do gjesh një artist shqiptar që ka lënë gjurmën e tij. Çuditërisht, ky fenomen vihet re

më shumë prej të huajve sesa prej nesh, shqiptarëve, vetë. Në fakt, ne duhej të ishim të parët që të krenoheshim me arritjet personale të secilit prej figurave të shquara te artit, kultures, sportit, nëpër botë. Por duket se jemi ne pikërisht ata që nuk i vleresojmë aq sa duhet.

… Koha ka treguar se, nëse ne nuk duam, nuk respektojmë dhe vlerësojmë punën e njëri tjetrit, nuk kemi pse të presim që këtë ta bëjë bota për ne!

Ky fenomen e zgjoji këtë ndjenjë tek ne artistët shqiptarë për të bërë diçka të përbashkët për t'u bërë shembuj krenarie për brezat që do të vijne, duke mos i lakuar thjesht emrat e përveçëm të secilit prej nesh, por si një buqetë emrash e vlerash që përbëjnë shpirtin e vendit tonë.

Artistët janë ambasadorët e vërtetë të një vendi. Nevoja për t'i bërë të njohur vlerat kulturore të kombit tonë është një detyrim patriotik i secilit prej nesh. Shqipëria ka kaluar shumë peripeci për të prezantuar vlerat e saj nëpërmjet artit dhe kulturës. Ajo shpesh ka hasur edhe në mosnjohjen e këtij detyrimi nga ana e vetë institucioneve që përfaqësojnë Shqipërinë nëpër vendet e ndryshme të botës. Këtu e kam fjalën për ambasadorët tanë. Ata duhet ta drejtojnë vëmendjen drejt një prezantimi të tillë dinjitoz.

Sipas meje të jesh ambasador i vendit tonë nuk do të thotë të jesh thjesht një nënpunës i emëruar "nga lart", por përfaqësuesi me gamë 360 gradë, i tërë kombit.

Shumë pak raste kam hasur, nëpër vendet e botës ku kam performuar, që një përfaqësues i vendit tim të ketë prezantuar anën më të bukur për të cilën ai ose ajo paguhen dhe që neve ndjehemi krenar që vimë nga i njejti vend.

Ndër këto raste dua të veçoj Ambasadën tonë në Londër, kur përfaqësuesi ynë atje ishte zoti Mal Berisha, një njeri që nuk ka reshtur asnjëherë së vëni në pah anët me pozitive të popullit tonë, duke kapërcyer atë rutinën administrative të dokumentave të njerëzve pa dokumenta…

Që në takimet e para, kryefjala e bisedave tona ka qenë dashuria për vendin, kulturën, artin, historinë, duke theksuar ato anët më pozitive aq të vyera që ishin rreze drite në mjegullnajën e gjërë të problemeve të një vendi, si ky i yni, gjatë periudhës së tranzicionit.

Gjithmonë kemi folur për këtë apo atë emër të përveçëm, që fliste gjuhën tonë dhe jehonen e suksesit të asaj apo atij bashkëatdhetari nga njëra anë e botës në anën tjetër. Ideja shkonte tek bashkimi i disa

prej artistëve që së bashku të tregonim diçka më shumë sesa një vlerë folklorike që i përket vetëm vendit tonë. Duhej të prezantoheshim duke folur një gjuhë të përbashkët artistike me botën. Të loznim jo vetëm napolonin apo muzikën e dasmave, sado të bukura që të jenë ato, por bash atë arsenalin e muzikës botërore, ku teatrot më të mëdha të krenoheshin kur të kishin brenda edhe artistët shqiptarë.

*Ideja e ambasadorit Mal Berisha për të organizuar veprimtarinë artistike "Notes on Albania" m'u duk hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm për të prezantuar Shqipërinë në Londër, nën një dritë tjetër. Ishte fjala që të performonim në një ndër sallat më të rëndësishme të kryeqytetit anglez, atë të Kolegjit Mbretëror të Muzikës, të njohur me emrin "*Amaryllis Fleming Concert Hall*".*

Prezantimi i "Notes on Albania" pati kureshti te madhe. Publiku përbëhej nga shumë të ftuar të trupit diplomatik të akredituar në atë qytet, nga spektatorë anglezë me shijet më të holla artistike, nga shqiptarë që jetonin në Londër, art-dashësish të muzikës klasike, dhe shumë admironjës të mij. Këta të fundit mezi prisnin të më shihnin te këndoja operën "Manon Lescout" të " Xhiakomo Puçinit", në Operan Mbretërore ROH. Më duhet të theksoj se ne do të

interpretonim në sallën ku janë përgatitur muzikantët me të mirë jo vetëm të Britanisë por edhe më gjërë. Krejt pranë sallës organizohet çdo vit ajo që njihet si BBC Proms.

Programi ishte përzgjedhur me repertor me muzike të kultivuar shqiptare dhe botërore. Edhe pse jeta ime është një udhëtim i pandërprerë, nga një vend i botës në tjetrin, duke interpretuar për një publik të larmishëm multinacional, të performoje para një audience të tillë kishte padyshim peshën e vet emocionale dhe një pergjegjësi tepër të madhe.

Çdo pjesë e programit gjeneronte energji të veçantë tek publiku dhe shfaqja shonte në një kreshendo që kulmoi me hymnin “
“Ta duam më shumë Shqipërinë”

Ajo krijoi një emocion kaq të fortë sa “miqtë e huaj” mbetën pa gojë nga kjo mbyllje madhështore ndërsa neve të gjithë, në skenë dhe në sallë u shkrehëm në lotë. Ndërsa bashkëatdhetaret tanë u ndien si asnjëherë tjetër të barabartë dhe krenar për identitetin e tyre me ata të huaj që kishin në krah. Në fund të koncertit, dallimi, që me një lloj keqardhjeje e them, që më përpara ndihej shumë midis publikut tonë dhe atyre të huaj, në atë mbrëmje shquhej vetëm nëse flisnin shqip ose në gjuhë të tjera.

Ky qe një hap i madh drejt një promovimi vlerash të kombit tonë që e kemi detyrim të

gjithë së bashku dhe vetëm së bashku mund ta arrijmë. E ndjeva dallimin në produksionin tim të radhës në ne ROH nje vit më vonë. Prania shqiptare ishte më e madhe në numër sesa më përpara. Unë nuk shikoja në sytë e tyre ndonjë ndjenje inferioriteti, përkundrazi - krenarie. Çdo vend ka kohën e tij për të ecur përpara, por vendin e bejmë ne njerëzit. Ky koncert do të ngelet në zemrën time përjetë. Jam e sigurtë që edhe të tjerët që kanë pasuar në edicionin e dyte dhe të tretë të "Notes on Albania" ruajnë të njëtat mbresa.

Kur të duam, respektojmë dhe vlerësojmë njëri tjetrin, atherë do të jemi qenie humane më të mira, patriotë më të mirë dhe një komb i tërë, edhe më i mire.

Në fund dua të them se pllaketin me emblemën e aktiviteit rrethuar me emrin e Ambasadës tonë në Londër dhe me emrin tim në mes, sikundër e morën edhe të gjithë pjesmarrësit, e mbaj si një ndër dhuratat më të bukura që ndonjëherë kam marrë në jetën time si artiste.

Falemnderit "Notes on Albania" që na mblodhe dhe na bëre aq krenar për atë që jemi: Shqipëtar!

Ermonela Jaho!

NOTES ON ALBANIA
Royal Collage of Music London
Londër, 16 Dhjetor 2012
Organizuar nën patronazhin e Ambasadorit të Shqipërisë
në Mbretërinë e Bashkuar,
Mal Berisha,
me pjesëmarrjen e sopranos me famë botërore
Ermonela Jaho,
Arlinda Morava dhe Orkestrës London–Albanian,
nën drejtimin e Mariela Cingo.

BY MAL BERISHA



Under the organisation of the Embassy of the Republic of Albania, the Royal College of Music welcomes an internationally acclaimed group of artists that features the talented soprano, Ermonela Jaho, the violinist, Alda Dizdari, the opera singer, Arlinda Morava, and the London- based ALB Trio led by Mariela Cingo.

Together, the group will take the audience on a musical journey with the performance of the famous arias of Puccini and Verdi, the Gypsy Airs of Pablo de Sarasate Zigeuner eisen, and the intimate works of Mendelssohn. The group will also perform classical Albanian songs, revealing to London some of the gems of our musical heritage.

This year s concert will be the first of a series that will bring to London Albanian artists from the motherland, Europe and US so as to promote, through musical excellence, the culture of our beautiful country, sharing with the British and international audience, the Notes on Albania!



A classical concert presented by the Embassy of the Republic of Albania in London to celebrate Albania through music

Notes on *Albania*

Monday 16 December 2013 | 7.00 pm

Royal College of Music, London
Prince Consort Rd, London SW7
2BS, United Kingdom



ERMONELA JAHO



Ermonela completed her studies in singing, pianoforte and phoniatry at the Academy of Santa Cecilia in Rome. By winning prizes such as the Puccini Competition, in Milan, Ancona, Rovereto, and Wexford, the young soprano caught the attention of music experts. Her performance of Violetta has been regarded by French critics as 'a revelation'. Since then, performances have led her to grace the stages of renowned venues throughout the world, from the MET to the NHK Opera in Japan. Ermonela's repertoire boasts the classic roles of most major operas. Her rendition of Suor Angelica at the Royal Opera House in London was released in 2012 and won best DVD at the International Opera Awards. Critics have described her interpretation of Angelica as 'sublime', 'ethereal,' and said that she portrayed her role 'with bone-shaking intensity'. Her interpretations have been broadcast by BBC 3 England, Mezzo Europe, ZDF Germany, Euronews, Sky Classic and RAI. Since her debut, audiences have been drawn by her singing and artistry.

ALDA DIZDARI



Alda received a Bachelor's Degree from the University of Bucharest and continued her Master's at the University of Illinois later completing her Advanced Instrumental Studies at the Guildhall School of Music and Drama with David Takeno, where she also held the prestigious Leverhulme String Fellowship for two years.Her triumphant debut at the Wigmore Hall and Southbank's Purcell Room have led to important appearances on BBC Radio 3, solo performances in Europe and the USA and the release of three highly acclaimed CDs, one of which was recorded live at Wigmore Hall. Alda was selected by Gramophone magazine as "One to Watch" in the May 2011 issue. That same year, she embarked on a solo tour entitled "In the Footsteps of Bach", promoting her studio CD with the same programme. Her musical activity has reached England, Holland, France, Spain, the US and Australia.

CHRISTIAN – ALEXANDRU PETRESCU



Professor Dr. Christian-Alexandru Petrescu is a violinist, composer, conductor, pianist and a scholar of musicology. He has studied violin and piano at the University of Arts in Bucharest under the legendary, Tiberiu Olah. As a composer he went on to heading the Association of the Vocal Composers of Romania. Dr. Petrescu has been awarded in France, Switzerland, Italy, Malta, Spain, China and Japan. He is vested with the highest award of the Romanian Academy, granted by the President of Romania; currently he is conductor of the Romanian classic and contemporaneous opera. He teaches conducting, theory of music, and methodology at Bucharest University. Dr. Petrescu has orchestrated the Albanian songs interpreted by Arlinda Morava.

ARLINDA MORAVA



Arlinda graduated in singing from the National University of Music in Bucharest, continuing her Master's in Switzerland. She has performed with the Bucharest Opera, touring in Austria, Germany, Greece Italy, Spain, Malta, Turkey and Switzerland. Her repertoire embraces a variety of roles, including Despina in Cosi fan Tutte, Suzana in La note di Figaro, Anna in Nabucco, Flora in Traviata, and Myzeta in La Boheme. In 2012 her performance as Papagena in The Magic Flute won her the VIP prize as the best performer in Romania. In 2013 she won the medal Cavaler of Dachia.

TOM BLACH



Since his highly acclaimed London debut in 1987 under the auspices of the Park Lane Group, Tom Blach has performed extensively in collaboration with many of today's finest artists. He has appeared on the BBC, in France, Spain, Germany and Russia, on radio worldwide, and has given recitals at the National Auditorium in Madrid, The Seoul Arts Centre, The Auditorium du Louvre and Salle Gaveau in Paris, the Herkulesaal in Munich,the Royal Festival, and the Queen Elizabeth and Wigmore Halls.

MARIELA CINGO



Mariela studied at the London College of Music. Whilst there, she won the 'Piano Concerto' competition, and the 'Beethoven Prize' in her schools honour. Mariela has worked with Martino Tirimo, John Lill, Angela Hewitt, Howard Shelley, Piers Lane, Leslie Howard and Peter Skeavard. Mariela performs not only as a soloist but also in her capacity as a chamber musician, ALB Trio being her most recent collaboration. Mariela firmly believes in investing in our children's future and teaches piano, chamber music, concerto repertoire and general musicianship regularly.

ELJON VEJSIU



Eljon studied at the Bulgarian National Academy of Music. Graduating in 2000, he was awarded a full scholarship to commence postgraduate studies with Professor Yfrah Neaman at the Guildhall School of Music and Drama in London. In 2008, Eljon was accepted onto the prestigious Advanced Postgraduate Diploma in Music at Birmingham Conservatoire, where he studied with Susanne Stanzeleit. Eljon performs regularly as a member of the Royal Philharmonic Orchestra, Brandenbourg Sinfonia and as a soloist with the Albanian Radio-Television Orchestra.

BRIKELDA SYLA



Brikelda Syla's musical training began with the cello and piano. Since graduating with a degree in music from the Academy of Fine Arts in Albania, she has gone on to perform regularly with European orchestras, chamber music groups and ensembles. Having studied with the renowned international cellist Natalya Pavluskaya, Brikelda gained the PGA diploma from Trinity College. She has taken master classes with distinguished musicians such as Richard Lester, Alexander Ivashkin and Gordon Back. Brikelda has won several music competitions and prizes and has vast experience of performing with symphony orchestras, and recordings. Her latest collaboration is with the ALB Trio.

KLARA BREGU



In 1996, Klara attended National University of Music in Bucharest, where she studied under Professor Aurel Niculescu. In 2001, she graduated with a Master's in cello and continues to work on a PhD in music. Klara has an active career in Bucharest and abroad as a member of the Romanian National Radio Orchestra, Chamber Radio Orchestra, Giurgiu Philharmonic Orchestra, and Symphony Bucharest Orchestra. Klara and Arlinda Morava have performed together in concert in "Albania - Land of Legends", promoting Albanian music in Romania, Germany and Switzerland.





- Londër, 18 Dhjetor 2013
  Royal College of Music
  Nga Aida Haziri
- Koncerti "Notes on Albania" ishte një paraqitje madhështore e artistëve shqiptarë në një nga skenat më prestigjioze të Londrës, në një mbrëmje të mbushur me emocion dhe krenari, Ambasada Shqiptare në Londër, nën drejtimin e Ambasadorit Mal Berisha, organizoi këtë ngjarje të paharrueshme në ambientet e mrekullueshme të Royal College of Music.
- Artistët brilantë Ermonela Jaho, Mariela Cingo, Alda Dizdari, Arlinda Morava, Brikelda Syla, Klara Bregu dhe Eljon Vejsiu, në bashkëpunim me Tom Blach dhe Christian Alexandru Petrescu, na dhuruan një buqetë emocionesh përmes interpretimit të tyre magjepsës të muzikës klasike.
- Në atë sallë të mbushur me publik të përzgjedhur, ne ndjemë fuqishëm frymën shqiptare dhe krenarinë për trashëgiminë tonë kulturore.
- Mirënjohje të thellë për të gjithë artistët dhe organizatorët që realizuan këtë mbrëmje të jashtëzakonshme, një nderim i denjë për artin dhe kulturën shqiptare në zemër të Londrës!

























































